



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.447/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtar, si dhe me pjesmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për kryetar të Kuvendit Komunal në Partesh, Nenad Cvetkovic, nga subjekti politik GI Narodna Sloga, dega në Partesh, paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe, dega në Partesh, për shkak të manipulimit me vota, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

I.PRANOHET pjesërisht si e bazuar ankesa e kandidatit për kryetar të Kuvendit Komunal në Partesh, Nenad Cvetkovic, nga subjekti politik GI Narodna Sloga, dega në Partesh, e cila mban shenjë ZL.Anr.447/2017, e datës 23.10.2017. Subjektit politik Lista Serbe, dega në Partesh, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 11.000,00 (njëmbëdhjetmijë) euro, për shkak të veprimëve të ndaluara gjatë fushatës zgjedhore, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

II. HUDHET si e palejuar kërkesa e kandidatit për kryetar të Kuvendit Komunal në Partesh, Nenad Cvetkovic, nga subjekti politik GI Narodna Sloga, dega në Partesh, me të cilën ka kërkuar që zgjedhjet e datës 22.10.2017, në Komunën e Parteshit të anulohen.

A r s y e t i m

PZAP-i më datë 22.10.2017, ka pranuar një ankesë nga kandidati për kryetar të Kuvendit Komunal në Partesh, Nenad Cvetkovic, nga subjekti politik GI Narodna Sloga, dega në Partesh, me të cilën ka pretenduar se me datë 20.10.2017, në ora 19:13, në televizionin RTK Live, është emituar një incizim i bisedës ndërmjet kandidatit për kryetar të Komunës së Parteshit, Dragan Petkovic, nga Lista Serbe dhe pronarit të këmbimorës nga Pasjan, Novica Sosic, ku dëgjohet se si do të blihen me ryshfet votuesit në Qendrat e Votimeve në Komunën e Parteshit. Në bisedë përmenden shifrat prej 20 deri 90 euro për një votë. Me këtë rast Prokuroria Publike ka reaguar dhe janë arrestuar dy persona Novica Sosic, pronar i këmbimorës dhe Jancic Momcilo, i cili më ato para, ka paguar ryshfet për votuesit.

Rasti i dhënies së ryshfetit për 6 votuesit ka ndodhur në kohën e heshtjes zgjedhore të shtunën, dhe në ditën e votimit. Gjatë votimit janë vërejtur rastet e shkeljeve të procesit zgjedhor dhe vetë procesi zgjedhor nuk ka qenë demokratik. Konsiderojmë se zgjedhjet nuk kanë qenë të rregullta dhe kërkojmë që ankesa jonë të miratohet dhe që kandidati Dragan Petkovic të diskualifikohet. Gjithashtu, ka kërkuar që zgjedhjet në Komunën e Parteshit të anulohen dhe të përsëriten.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një CD-audio inqizim lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë të datës 25.10.2017, subjekti politik Lista Serbe, ka theksuar se kjo ankesë është e ndërtuar në bazë të insinuimeve, ku një bised qesharake në mes të dy personave mundohet që të nxiret nga konteksti dhe të paraqitet si një bised për tentim blerjen e votave dhe nuk ofron asnjë dëshmi e cila e ndërlidh kandidatin për kryetar të Komunës së Parteshit nga Lista Serbe, Dragan Petrovic dhe Jancic Momocillo.

Më tej ka theksuar se ankuesi pretendon se personat përgjegjës për këtë vepër janë arrestuar, që do të thotë se blerja e supozuar e votave është parandaluar nga një veprim i prokurorisë dhe se nëse kandidati për kryetar të komunës së Parteshit, nga Lista Serbe, Dragan Petković që do të merrte pjesë lidhur me çfarëdo blerje të votave dhe dhënien e ryshfetit, ai do të arrestohej ose ndaj atij do të fillonte hetimi dhe se ata si subjekt politik nuk mund të mohojnë se ka pasur tentime individuale të manipulimeve me vota. Gjithashtu, ekziston mundësia se disa persona janë thirrur në emër të subjektit politik Lista Serbe dhe kanë tentuar të manipulojnë me votuesit. Mirëpo, manipulime të tilla nuk kanë fare lidhje me subjektin politik Lista Serbe dhe fare nuk e ndërlidhin Dragan Petković me personat e arrestuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj pretendimet ankimore provat e administruar secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është pjesërisht e bazuar

Paneli, nga CD-audio inqizimi-biseda telefonike, e ofruar si provë nga parashtuesi i ankesës e cila gjendet në shkresat e lëndës, nga transkripti i asaj bisedës telefonike, del se zhvillohet biseda në mes dy personave lidhur me shitblerjen e votave në të cilën bised është i involvuar edhe një person (poseduesi i të hollave të cilat do të përdorehin për blerjen e atyre votave). Citohet transkripti: *“A ke dëgjuar; Po unë nuk kërkoj shumë, nga 20, nga 50, dhe shiko në të vërtetë duhet të shikohen skamnoret, skamnoret as Zoti nuk i do; Po unë çka me bo tani, më duhet secila votë, nuk mund të them jo; Jo, jo, parat duhet të jepen, pa para nuk bën, por shumë është nga 50; Shko tërhiqi, tërhiqi nga këmbimorja të gjitha që i ke atë ditë, që të investojmë e pastaj në 4 vitet e ardhshme do ti kthej, nga pak, nga pak, me kamatë më llogarit, nuk ka asnjë problem; Paret nuk janë problem aspak, veç a ke dikë të i japim; Ka, ka, a e dëgjove bisedën; Po në rregull, ato janë te imëta, nga 50...; Je dëshmitar i gjallë; 100 euro nga xhepi do i nxjerr, nuk është problem, sa...3 vota deri në 90 euro, nuk janë shumë; Jo, jo, jo, për shtëpi ndoshta nga 20 euro se përndryshe unë nuk mund të jap aq shumë”.*

Po ashtu edhe në Raportin Policor të datës 25.10.2017, konstatohet se me datë 21.10.2017, në orën 14:00, hetuesit e Sektorit Rajonal i Hetimëve në Gjilan, kanë marr një informacion se në Komunën e Parteshit, përfaqësues të subjektit politik të Listës Serbe, janë duke shpërndar të holla-para tek qytetarët me qëllim që gjatë ditës së nesërme me 22.10.2017 të votojnë Listen Serbe, konkretisht kandidatin për kryetar të Kuvendit Komunal të Parteshit, Dragan Petkovic,

njëkohësisht janë informuar se ndër qytetarët që ju kanë ofruar para është dëshmitari me iniciale Z.S. nga fshati Pasjan. Pasi që kanë marr këtë informacion kanë shkuar në fshatin Pasjan, ku janë identifikuar dy qytetar Novica Susic dhe Momqillo Jancic, tani të dyshuar, ku më pas të dy janë intervistuar në cilësinë e të dyshuarëve në dyshimin se kanë kryer veprën penale dhënia ose marrja e rryshfetit në lidhje me votimin, mirëpo gjatë intervistimit kanë mohuar të kenë kryer këtë vepër penale. Ndërsa, Novica Susic nuk e ka mohuar se ka komunikuar me kandidatin për kryetar të Komunës së Parteshit Dragan Petkovic. Më pas dy të dyshuar janë ndaluar për 48 orë në Stacionin Policor. Po ashtu Gjykata, ndaj dy të dyshuarve Novica Susic dhe Momqillo Jancic ka caktuar masën e arrestit Shtëpiak. Mbi bazën e asaj që është vërtetuar si më lartë PZAP vërtetoj në këtë rast, se kandidati për kryetar të Kuvendit Komunal të Parteshit Dragan Petković nga radhët e subjektit politik Lista Serbe, ka bërë shkelje të nenii 3.6 të Rregullës Nr.01/2012.

Pretendimet e subjektit politik Lista Serbe, të paraqitura përmes përgjigjes në ankesë, të cilët pretendojnë se këto manipulime me vota nuk kanë fare lidhje me subjektin politik Lista Serbe dhe fare nuk e ndërlidhin Dragan Petković me personat e arrestuar. Paneli, pretendimet e tilla i vlerësoi si të pa bazuara dhe si të tilla nuk i pranoi pasi që këto pretendime nuk janë të argumentuara me fakte, ndërsa nga transkripti që i është bashkangjitur ankesës në mënyrë të sigurt është vërtetuar se veprimet e kandidatit për kryetar të Kuvendit Komunal të Parteshit, Dragan Petkovic, janë të ndaluara dhe në kundërshtim me nenin 3.6 të Rregullës Nr.01/2012 i cili përcakton se *“Në qoftë se subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij premtojnë ndonjë shpërblim financiar më qëllim të përfitimit të mbështetjes së votuesve, subjekti politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dënohet me pesëmijëenjëqind (5.100) euro deri në njëzetëmijë (20.000) euro”*.

Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi morri parasysh shkeljet e lartpërmendura, dhe shqiptoi gjobën duke u bazuar në nenin 120 par. 1 pika (c) LZP-së, lidhur me nenin 3.6 të Rregullës Nr.01/2012 për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave të PZAP-it, duke marr parasysh natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme, që konsiston në faktin se Lista Serbe, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit zgjedhor, shkeljet e ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë, që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore, si dhe shumën e fondeve që ka marr subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore.

Paneli, në pikën II të dispozitivit nuk e ka bërë vlerësimin e ligjshmërisë së ankesës të ankuesit në pjesën që i referohet anulimit dhe përsëritjes së Zgjedhjeve në Komunën e Parteshit, pasi që shkeljet e pretenduara në ankesë lidhen me rezultatin e votimit dhe për këto shkelje ankesa duhet të parashtrohet pas shpalljes së rezultatëve përfundimtare nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës.

Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës e subjektit politik GI NS, dega në Partesh, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit

nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesë, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 118 dhe nenit 120 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.447/2017 me datën 25.10.2017

Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.